



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

REZULTATET PËRMBLEDHËSE TË VLERËSIMIT NGA PYETËSORI “STUDENTI MËSIMDHËNËSIN”

Programi Studimor: Menaxhimi i emergjencave (MA)

Viti Akademik: 2025/2026

Semestri Dimëror, 2025

1. Qëllimi i Raportit

Ky raport ka për qëllim prezantimin e analizës së vlerësimit të lëndëve të programit studimor Menaxhimi i emergjencave – Master, duke u bazuar në perceptimet e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies, organizimin e lëndëve dhe materialet akademike të përdorura gjatë semestrave përkatës. Ky proces ka një rëndësi të veçantë për Kolegjin e Biznesit, duke shërbyer si një instrument strategjik për monitorimin e standardeve të cilësisë akademike dhe për orientimin e zhvillimeve të ardhshme brenda programit.

Ky raport fokusohet në perceptimet e studentëve gjatë semestrit dimeror, duke ofruar një pasqyrë të integruar dhe të detajuar të cilësisë së mësimdhënies dhe strukturës akademike.

Raporti synon të ofrojë një pasqyrë të thelluar mbi mënyrën se si studentët perceptojnë përmbajtjen e lëndëve, metodologjitë e mësimdhënies të aplikuara nga mësimdhënësit, si dhe qartësinë dhe strukturën e materialeve akademike. Përmes këtij vlerësimi, theksohet rëndësia e monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike, duke u fokusuar jo vetëm në rezultatet numerike, por edhe në identifikimin e praktikave të suksesshme dhe aspekteve që kërkojnë përmirësim.

Vlerësimi synon gjithashtu të ofrojë informacion të detajuar për mësimdhënësit dhe stafin akademik, duke i mundësuar atyre të planifikojnë dhe të implementojnë ndërhyrje të synuara për avancimin e cilësisë së mësimdhënies, si dhe për të maksimizuar efektivitetin e procesit mësimor. Rezultatet e këtij vlerësimi përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe për integrimin e praktikave më të mira në mësimdhënie, duke siguruar që programi studimor Menaxhimi i emergjencave – Master të mbetet në përputhje me standardet moderne akademike dhe me trendet aktuale të fushës.

Të dhënat e mbledhura për semestrin dimëror do të ilustrojnë performancën e lëndëve, dimensionet më të vlerësuara dhe fushat me potencial për përmirësim, duke u pasqyruar më tej në analizën grafike dhe tabelare që ndiqet.

Përmes këtij raporti, identifikohen elementët që perceptohen si të fortë nga studentët, si dhe ato që kërkojnë vëmendje dhe përmirësim, duke ofruar kështu një instrument të qartë për avancimin e cilësisë akademike dhe për rritjen e përvojës akademike të studentëve në programin studimor Menaxhimi i emergjencave – Master.

2. Metodologjia e Vlerësimit

Vlerësimi i lëndëve të programit studimor Menaxhimi i emergjencave – Master është realizuar përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik, duke përdorur një instrument të standardizuar të mbledhjes së të dhënave, i cili konsiston në një pyetësor me 16 pyetje të dizajnuara për të matur perceptimin e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies, organizimin akademik dhe materialet mësimore të përdorura gjatë semestrave. Ky instrument është konceptuar duke u bazuar në praktikatat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare për vlerësimin e cilësisë akademike në arsimin e lartë.

Pyetësi përfshin dimensione të ndryshme të procesit mësimor, të cilat janë thelbësore për një analizë të gjithanshme dhe të integruar të cilësisë së lëndëve.

Për semestrin dimëror, ky instrument u aplikua në mënyrë të njëjtë, duke siguruar krahasueshmëri të rezultateve me semestrat e mëparshëm dhe duke mundësuar një pasqyrë të vazhdueshme mbi perceptimet e studentëve gjatë gjithë vitit akademik.

Dimensionet e vlerësuara përfshijnë:

1. **Organizimi dhe struktura e lëndës** – vlerësohet koherenca e përmbajtjes së lëndës, ndarja logjike e moduleve dhe seancave mësimore, si dhe përshtatja e tyre me objektivat e programit studimor.
2. **Qartësia e objektivave dhe lidhja me përmbajtjen e mësimin** – matet mënyra se si objektivat mësimore komunikohen tek studentët dhe sa ato reflektojnë përmbajtjen dhe fokusin e lëndës.
3. **Përdorimi i metodave didaktike dhe shembujve praktikë** – analizohen teknikat e mësimdhënies të aplikuara nga mësimdhënësi, përfshirë përdorimin e shembujve praktikë, studimeve të rasteve dhe metodave interaktive që kontribuojnë në kuptimin e koncepteve të avancuara.
4. **Gatishmëria dhe qasja e mësimdhënësit** – vlerësohet disponueshmëria e mësimdhënësit për të ofruar mbështetje akademike, aftësia për të dhënë shpjegime të qarta dhe për të adresuar pyetjet e studentëve në mënyrë efektive.
5. **Përgatitja dhe përdorimi i materialeve mësimore dhe resurseve digjitale** – matet cilësia dhe relevanca e materialeve të përdorura, duke përfshirë literaturën bazë, materialet digjitale, prezantimet dhe burimet e tjera të integruara në procesin mësimor.
6. **Interaktiviteti dhe përfshirja e studentëve në procesin mësimor** – shqyrtohet niveli i angazhimit të studentëve, përdorimi i diskutimeve, pyetje-përgjigjeve dhe aktiviteteve të tjera që nxisin pjesëmarrje aktive dhe zhvillimin e aftësive kritike.

Studentët dhanë përgjigje në një shkallë Likert me pesë nivele, ku 1 korrespondon me "shumë i pakënaqur" dhe 5 me "shumë i kënaqur". Ky sistem i vlerësimit lejon një matje të kuantifikueshme të perceptimeve dhe përqendrimin në aspekte të veçanta të cilësisë akademike. Përpunimi i të dhënave është realizuar duke llogaritur mesataren e përgjigjeve për secilën lëndë, duke përjashtuar përgjigjet e shënuara si "NA" (jo të aplikuara), për të siguruar që rezultati pasqyron vlerësimin real të pjesëmarrësve.

Përveç analizës kuantitative, ky proces ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të hollësishme mbi perceptimet e studentëve, duke identifikuar praktikën më të suksesshme të mësimdhënies dhe fushat që mund të përmirësohen. Ky nivel detajimi mundëson që programi studimor Menaxhimi i emergjencave – Master të avancojë në standardet e cilësisë akademike dhe të kontribuojë në përmirësimin e përvojës akademike të studentëve brenda Kolegjit të Biznesit.

3. Rezultatet e vlerësimit – Viti II-rë, semestri i tretë

Mesataret e vlerësimeve për lëndët e semestrit dimëror reflektojnë perceptimet e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies, organizimin akademik dhe materialet mësimore. Analiza është bazuar në të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit standard me 16 pyetje, ku secila pyetje kontribuon në formimin e një vlerësimi të përgjithshëm për secilën lëndë. Mesataret janë përpunuar duke llogaritur përgjigjet e studentëve, duke përjashtuar opsionin "NA" (jo të aplikuara), për të siguruar që rezultatet pasqyrojnë perceptimet reale të pjesëmarrësve.

Viti akademik 2025/26 Semestri III Viti i II-të	
Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve	4.62
Paisjet dhe proceset teknologjike	4.65
Menaxhimi i emergjencave ndërkombëtar	4.71
Planifikimet emergjente të integruara	4.59
Menaxhimi i emergjencave në kondita të ndërlikuara	4.73

Analizë e Lëndëve:

Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve – Viti i II-të

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.62**, duke reflektuar një perceptim shumë pozitiv të studentëve për qartësinë e koncepteve dhe mënyrën e strukturimit të materialeve mësimore. Studentët evidentuan rëndësinë e lëndës që merr në analizë, vlerëson dhe përfshinë problemet më të vecanta që ndikojnë në cenimin e sigurisë kombëtare dhe në jetën e komunitetit dhe pasurinë e tij, metodologjinë e kërkimit, hulumtimit analizës dhe vlerësimit të rreziqeve që mund të bëhen prezent në jetën tonë kombëtare e të komunitetit dhe që rrezikojnë ecurinë e zhvillimit të jetës së vendit.

Shembujt praktikë, dhe diskutimet interaktive kontribuan në zhvillimin e aftësive logjike, analitike dhe problem-zgjidhëse, duke i ndihmuar studentët të kuptojnë rolin dhe aplikimin e teknologjisë në zgjidhjen e problemeve reale.

Paisjet dhe proceset teknologjike - Viti i II-të

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.65**, duke treguar një perceptim shumë pozitiv të studentëve për qartësinë e ligjëratave dhe rëndësinë e koncepteve matematikore të trajtuara. Studentët evidentuan pajimet e sistemit organizativ prodhues, njohurit e përgjithshme, strukturat, transportin në sistemin organizativ prodhues, zhurmën dhe dridhjet në hapësirën punuese, rrezatimin në hapësirën punuese, racionalizimin e prodhimit, zhvillimi i organizimit shkencor të punës, fillet e organizimit shkencor të punës, parimet e përgjithshme të pajimeve të sistemit organizativ prodhues, përgatitjen e procesit të prodhimit, hulumtimin e tregut, përgatitjen teknologjike dhe të operacionit teknologjik të punës, hartimin e planit operativ dhe dokumentacionin teknik e teknologjik të përgatitjes së punës

Shembujt praktikë, demonstrimet vizuale dhe kontribuan në zhvillimin e aftësive analitike dhe mendimit abstrakt.

Menaxhimi i emergjencave ndërkombëtar - Viti i II-të

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.71**, duke reflektuar një perceptim pozitiv të studentëve për qartësinë e koncepteve dhe strukturën e ligjëratave. Studentët evidentuan rëndësinë në aktivitetin shkencor, bashkëpunues, planifikues dhe menaxherial të fatkeqësive në kuader të operacioneve të emergjencave në nivelin ndërkombëtar, ndërtimit të planeve të bashkëveprimit, si elementi parësor për menaxhimin e trupave në detyrat e tyre të vështira me të cilat mund të përballen, duke u vënë në përbërje të strukturave të emergjencave ndërkombëtare rajonale, europiane e me gjërë.

Planifikimet emergjente të integruara - Viti i II-të

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.59**, duke reflektuar një perceptim shumë pozitiv të studentëve për qartësinë e ligjëratave dhe rëndësinë e temave të trajtuara. Studentët evidentuan

dhe janë në gjendje të shpjegojnë metodat teorike dhe praktike për mënyrat e kryerjes së kërkimit shkencor, si dhe përpunimin e të dhënave, analizave, punimin dhe raportimin, dhe prezantimin e rezultateve, zbatojnë me sukses sistemin e integruar të emergjencave, krahasojnë njohuritë me komponentët bazë të SIME-së, interpretojnë parimet bazë të SIME-së, organizojnë funksionimin e SIME-së, planifikojnë planet e veprimit për menaxhimin e emergjencave gjatë incidenteve.

Menaxhimi i emergjencave në kondita të ndërlikuara - Viti i II-të

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.73**, duke reflektuar një perceptim pozitiv të studentëve për qartësinë e ligjëratave dhe mënyrën e strukturimit të mësimdhënies. Studentët evidentuan rolin dhe rëndësinë e menaxhimit të emergjencave dhe operacioneve në kondita të ndërlikuara; sistemin informativ në menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme, menaxhimin dhe planifikimin interaktiv të resurseve; përdorimin e Sotueret për planifikimin grupor interaktiv, menaxhimin e integruar të rrezikut; modelin për mbështetjen e planit për situata emergjente, efektshmërinë e procesit të menaxhimit të njësitë e prekura; dhe llojet e gjendjeve të jashtëzakonshme.

Viti akademik 2025/26 Semestri I Viti i I	
Organizimi teorik dhe praktik i emergjencave	4.65
Lidershipi në emergjenca	4.60
Menaxhimi i programeve preventive në emergjenca	4.63
Metotologjia e hulumtimeve shkencore	4.52
Menaxhimi i planeve të Emergjencave	4.55

Organizimi teorik dhe praktik i emergjencave – Viti I

Lënda u vlerësua me një mesatare prej 4.65, duke reflektuar një perceptim shumë pozitiv të studentëve për qartësinë e koncepteve dhe mënyrën e strukturimit të materialeve mësimore. Studentët evidentuan rëndësinë në proceset e vendimmarrjes, parimet, konceptet dhe rolet e gatishmërisë, konceptet dhe parimet e komunikimit dhe menaxhimit të informimit, konceptet themelore të menaxhimit të resurseve, sistemi i komandës dhe menaxhmenti, ekipet e menaxhimit të incidentit, dhe organizimin dhe udhëheqjen e operacioneve të kërkim shpëtimit.

Shembujt praktikë, dhe diskutimet interaktive kontribuan në zhvillimin e aftësive logjike, analitike dhe problem–zgjidhëse, duke i ndihmuar studentët të kuptojnë rolin dhe aplikimin e teknologjisë në zgjidhjen e problemeve reale.

Lidershipi në emergjenca - Viti I

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.60**, duke treguar një perceptim shumë pozitiv të studentëve për qartësinë e ligjëratave dhe rëndësinë e koncepteve matematikore të trajtuara. Studentët evidentuan vlerën e **moduleve që përfshijnë zhvillimi historik i shkencës së menaxhimit, fazat e zhvillimit të menaxhimit dhe shtyllat kryesore, shkollat e menaxhimit, rëndësinë, natyrën, funksioni menaxherial.**

Shembujt praktikë, demonstrimet vizuale dhe detyrat e strukturuar kontribuan në zhvillimin e **aftësive analitike dhe mendimit abstrakt**, duke ndihmuar studentët të aplikojnë konceptet matematikore në situata reale të programimit dhe modelimit kompjuterik.

Menaxhimi i programeve preventive në emergjenca - Viti I

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.63**, duke reflektuar një perceptim pozitiv të studentëve për qartësinë e koncepteve dhe strukturën e ligjëratave. Studentët evidentuan rëndësinë të paisen

me njohuritë profesionale mbi aplikimin e metodave të ndryshme në arritjen e përfekcionimit të programimit preventiv në emergjencë. Arritja e njohurive menaxhuese të programimit të emergjencave preventive dhe përpilimi i programeve preventive të emergjencave, zhvillimin dhe pasojat e situatave emergjente si dhe kornizën institucionale për udhëheqje me parandalimin emergjente të ngjarjes.

Demonstrimet laboratorike, shembujt praktikë dhe ushtrimet e simuluar kontribuan në zhvillimin e **aftësive praktike dhe kuptimit konceptual**, duke ndihmuar studentët të lidhin teorinë e elektroteknikës me aplikimet në kompjuterikë, sistemet embedded dhe inxhinierinë e harduerit.

Metodologjia e hulumtimeve shkencore - Viti I

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.52**, duke reflektuar një perceptim shumë pozitiv të studentëve për qartësinë e ligjëratave dhe rëndësinë e temave të trajtuara. Studentët evidentuan dhe janë në gjendje të shpjegojnë metodat teorike dhe praktike për mënyrat e kryerjes së kërkimit shkencor, si dhe përpunimin e të dhënave, analizave, punimin dhe raportimin, dhe prezantimin e rezultateve.

Shembujt praktikë, përdorimi i mjeteve kompjuterike statistikore dhe ushtrimet e orientuara drejt zgjidhjes së problemeve kontribuan në njohjen e metodave të kërkimit shkencor, ndërtojnë hipotezat e nevojshme për hulumtime shkencore, përshtatin metodat e kërkimeve shkencore, dhe nxjerrin përfundime për metodologjinë e kërkimeve shkencore.

Menaxhimi i planeve emergjente - Viti I

Lënda u vlerësua me një mesatare prej **4.55**, duke reflektuar një perceptim pozitiv të studentëve për qartësinë e ligjëratave dhe mënyrën e strukturimit të mësimdhënies. Studentët evidentuan rëndësinë për të fitu njohuritë nga fusha e menaxhimit të planeve të emergjencave, për sa i përket rëndësisë, funksionimit dhe sfidave të produktivitetit të punës gjatë përballjes me fatkeqësitë, metodologjinë e ndërtimit të planeve për menaxhimin e trupave në detyrën më të vështirë me të cilën mund të përballen struktura të sigurisë së shtetit.

4. Analiza Përmbledhëse e Rezultateve të Vlerësimit

Kjo pjesë e raportit ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të integruar, të detajuar dhe krahasuese të perceptimeve të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies, strukturën akademike dhe materialet mësimore të përdorura në programin Menaxhimi i emergjencave – Master gjatë semestrit dimëror dhe veror. Përmes këtij seksioni, prezantohen trendët e përgjithshëm të performancës së lëndëve, dimensionet më të forta të programit dhe fushat që ofrojnë mundësi për përmirësim, duke reflektuar standardet akademike të Kolegjit të Biznesit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në arsimin e lartë.

Të dhënat për këtë analizë janë mbledhur përmes pyetësorit standard me 16 pyetje, i dizajnuar për të matur perceptimet e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies, qartësinë e objektivave, përgatitjen dhe përdorimin e materialeve mësimore, metodologjitë didaktike dhe gatishmërinë e mësimdhënësve për mbështetje akademike. Secila pyetje kontribuon në formimin e një vlerësimi të integruar për secilën lëndë, duke lejuar një analizë të saktë dhe kuantifikueshme.

Përpunimi i të dhënave është realizuar duke llogaritur mesataret për secilën lëndë dhe duke përjashtuar përgjigjet “NA”, gjë që garanton që rezultatet pasqyrojnë perceptimet reale të studentëve.

Kjo qasje analitike mundëson identifikimin e modeleve të performancës së lëndëve dhe evidentimin e elementeve të suksesit, si dhe fushave që kërkojnë vëmendje dhe përmirësim. Përveç vlerësimit numerik, raporti synon të nxjerrë njohuri të vlefshme strategjike për menaxhimin e programit dhe për avancimin e cilësisë akademike në mënyrë të qëndrueshme.



Kjo pjesë përfshin një krahasim të rezultateve midis semestrave të kaluar dhe semestrit dimëror, duke identifikuar trendet e përparimit, dimensionet më të forta dhe fushat që mund të fuqizohen përmes metodave interaktive dhe materialeve digjitale të avancuara. Analiza krahasuese lejon të evidentohen praktikatat më të suksesshme dhe strategjitë e përshtatshme për zhvillimin profesional të stafit akademik, si dhe për rritjen e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve.

Në përputhje me standardet akademike, kjo analizë thekson rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike, duke u fokusuar jo vetëm në rezultate numerike, por edhe në identifikimin e praktikave më të mira dhe inovative të mësimdhënies. Rezultatet e paraqitura në këtë seksion shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, integrimin e materialeve digjitale, dhe implementimin e praktikave interaktive që rrisin aftësitë analitike, kritike dhe profesionale të studentëve.

Kjo qasje e integruar dhe e detajuar siguron që programi Menaxhimi i emergjencave – Master të ruajë dhe avancojë standardet e tij akademike, duke e bërë programin të përshtatshëm për sfidat e tregut profesional dhe kërkesat e zhvillimit të aftësive kërkimore dhe menaxheriale në nivel të lartë.

Për të vizualizuar në mënyrë më të qartë performancën e lëndëve dhe perceptimet e studentëve për semestrin dimëror, grafikët dhe tabelat e mëposhtme paraqesin mesataret e vlerësimeve për secilën lëndë. Këto paraqitje grafike lehtësojnë identifikimin e lëndëve me rezultate më të larta dhe dimensioneve më të forta, si dhe evidentojnë fushat ku mund të ndërmerren masa për përmirësim, duke mundësuar një analizë komparative dhe sintetike të performancës së programit Menaxhimi i emergjencave – Master.

Grafiku 1: Mesatarja e Vlerësimit të Lëndëve – Semestri I dhe II-të, Programi Studimor Menaxhimi i emergjencave – Master



Ky grafik paraqet mesataret e vlerësimeve për lëndët e semestrit dimëror në programin Menaxhimi i emeregjencave-Master. Lëndët me mesatare më të lartë tregojnë perceptim të lartë

mbi qartësinë e koncepteve, strukturën logjike të ligjëratave, përdorimin e shembujve praktikë dhe gatishmërinë e mësimeve për mbështetje individuale. Lëndët me vlerësime më të ulëta, megjithatë mbi nivelin e kënaqësisë, sugjerojnë hapësira për rritje të interaktivitetit, diskutimeve dhe përdorimin e materialeve digjitale më të avancuara. Ky vizualizim lejon një krahasim të performancës së lëndëve dhe identifikimin e fushave ku mund të ndërmerren masa për përmirësim, duke siguruar një bazë të qartë për zhvillimin profesional dhe avancimin e cilësisë akademike.

Bazuar në mesataret e vlerësimeve për lëndët e semestrit dimëror, mund të nxjerrim disa vëzhgime kryesore që ofrojnë një pamje të integruar të performancës së programit Menaxhimi i emergjencave-Master dhe perceptimeve të studentëve mbi cilësinë akademike:

1. ***Performanca e lartë e të gjitha lëndëve*** – Të gjitha lëndët e vlerësuara kanë marrë mesatare mbi 4.5, duke treguar një nivel të lartë kënaqësie nga studentët. Ky rezultat reflekton se përmbajtja e lëndëve, metodat e mësimit dhe organizimi akademik janë në përputhje të mirë me pritshmëritë e studentëve, duke siguruar një përvojë akademike efektive dhe të qëndrueshme.
2. ***Lëndët me vlerësimet më të larta*** – Menaxhimi i emergjencave në kondita të ndërlikuara dhe Organizimi teorik dhe praktik i emergjencave, dallohen për performancën e tyre të lartë. Kjo tregon se qartësia e koncepteve, struktura e ligjëratave, përdorimi i shembujve praktikë dhe gatishmëria e mësimeve për mbështetje individuale kanë një ndikim të konsiderueshëm tek perceptimi i studentëve dhe në thellimin e njohurive të tyre.
3. ***Dimensionet më të vlerësuara nga studentët*** – Studentët evidentuan disa elementë kyç të cilësisë akademike: qartësinë e objektiveve, përdorimin e shembujve praktikë, gatishmërinë dhe qasjen profesionale të mësimeve, si dhe përfshirjen e resurseve digjitale dhe materialeve mbështetëse. Këto dimensionet kontribuojnë në një proces mësimor të suksesshëm dhe zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike të studentëve.
4. ***Fushat me potencial për përmirësim*** – Lëndët me mesatare më të ulët, megjithatë mbi 4.5, evidentojnë hapësira për zhvillim, veçanërisht në drejtim të rritjes së interaktivitetit gjatë ligjëratave dhe përdorimit të materialeve digjitale dhe aplikative të avancuara. Aktivitetet praktike, diskutimet më të strukturuar dhe metodat interaktive mund të rrisin pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe të thellojnë kuptimin e përmbajtjes akademike.
5. ***Impakti i perceptimeve mbi zhvillimin profesional*** – Vlerësimet e studentëve ofrojnë informacion të vlefshëm për planifikimin e zhvillimit profesional të stafit akademik dhe për adaptimin e praktikave të mësimit në përputhje me trendet moderne. Analiza e këtyre të dhënave mundëson identifikimin e praktikave të suksesshme që mund të konsolidohen dhe të standardizohen për të gjithë programin, si dhe ofron rekomandime për përmirësime konkrete ku është e nevojshme.
6. ***Kuptimi i përgjithshëm i rezultateve*** – Rezultatet e semestrit dimëror reflektojnë një performancë të lartë dhe të qëndrueshme të programit, me fokus të qartë në cilësinë e mësimit, zhvillimin e aftësive të studentëve dhe përdorimin efektiv të metodave

didaktike. Kjo pasqyrë e integruar ndihmon në monitorimin e performancës së lëndëve dhe planifikimin e përmirësimeve strategjike për semestrat e ardhshëm.